



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurë të përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-101 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-101 datë 20.3.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1188/7 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023 miratoi:

AKTVENDIMI
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqje të lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, nr.08-117 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzion, ark.nr.02-1007/10 datë 8.3.2023, e miratoi propozimin e Drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-101 datë 7.3.2023 për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, nr.08-117 datë 5.1.2015, për faktin se pas kryerjes së kontrollit të rregullt administrat, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1001/1 datë 3.3.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar (dhënë) nga Agjencia, nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, respektivisht nuk e ka paguar kompensimin (tarifën) vjetore për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga Agjencia më 9.3.2023 drejtuar transmetuesit në fjalë ka dërguar Shkresë PA1 nr.08-101 datë 9.3.2023, për njoftimin e tij se nëse nuk paguan kompensimin (tarifën) vjetore për lejen për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 20.3.2023, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i financave dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-1001/2 datë 20.3.2023. se SHTR RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, më 7.3.2023, ka bërë pagesën në shumë prej 10.000,00 (dhjetë mijë) denarë dhe në 20.3.2023 ka bërë pagesën në shumë prej 6.599,00 (gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) denarë me të cilën transmetuesi kompensimin (tarifën) vjetor e pagoi në tërësi.

Уп1 Бр.08.101
Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurë të përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-101 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-101 datë 20.3.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr 2-1188/7 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, vendosi të ndërpresë procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjenca për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshilli juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

¹ Алинеите 8 и 9 се избришани, види: член 8 од Закон за изменување и дополнување на Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги („Службен весник на Република Македонија” бр.248/18).